



BURSA PËR KURSIN VEROR TË GJUHËS, LETËRSISË DHE KULTURËS BULLGARE

Në zbatim të programit të bashkëpunimit dypalësh në fushën e arsimit, shkencës dhe kulturës, Qeveria e Republikës së Bullgarisë ofron 3 (tre) bursa për studentë dhe specialistë shqiptarë, të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në kurset verore të gjuhës, letërsisë dhe kulturës bullgare. Kurset do të mbahen pranë Universitetit “St. Kliment Ohridski” të Sofjes, në datat 15 korrik- 4 gusht 2018 dhe pranë Universitetit “St. Cyril and St. Methodius University” të Veliko Turnovos në datat 16 korrik- 5 gusht 2018.

Kandidatët e interesuar për kurset e mësipërme duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë brenda datës **4 maj 2018** dokumentacionin përkatës sipas listës në vijim:

1. Kërkesën për ndjekjen e kursit veror të gjuhës bullgare. Kërkesa të jetë e nënshkruar nga kandidati dhe të përmbajë adresë e-mail dhe numër kontakti;
2. Formularin e aplikimit;
3. Letrën mbështetëse nga Departamenti i Gjuhëve Sllave e Ballkanike të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës;
4. Raportin mjekësor;
5. Fotokopjen e kartës së identitetit;
6. 2 (dy) fotografi;

Nënvizojmë se për bursat e ofruara për kursin e verës në Bullgari duhet të aplikojnë kryesisht studentë, të cilët mësojnë gjuhën bullgare pranë Departamentit të Gjuhëve Sllave e Ballkanike të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës.

Pala bullgare përballon shpenzimet për ushqimin, akomodimin dhe programin mësimor dhe kulturor, ndërsa shpenzimet e udhëtimit vajtje-ardhje do të mbulohen nga vetë pjesëmarrësit e kursit.

Bashkëlidhur këtij njoftimi ndodhen formularët e aplikimit për kurset e mësipërme. Për më shumë informacion referojuni adresave në faqen e website:

www.uni-vt.bg;

e-mail: deo_vtu@abv.bg; i

www.slav.uni-sofia.bg/index.php/summer-seminar;

e-mail: summer_seminar@slav.uni-sofia.bg;

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS